



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 979 Prot.

Tiranë, më 25.03.2026

RELACION

MBI

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S,
“GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGJISË DHE VEPRIMTARIA E ERE-S GJATË
VITIT 2025”

Bordit të ERE-s:

Te Nderuar anëtar te Bordit,

Në zbatim të parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të nenit 21 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ERE duhet të paraqesë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë raportin vjetor mbi gjendjen e sektorit të energjisë elektrike, sektorit të gazit natyror dhe veprimtarinë e ERE-s për vitin paraardhës, brenda datës 31 mars.

Theksojmë se, edhe përgjatë vitit 2025, në zbatim të vendimit nr. 134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, për miratimin e “Manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, ERE ka raportuar periodikisht në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me ecurinë e masave të marra për zbatimin e detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë pas miratimit të raportit vjetor të ERE-s. Gjithashtu, ERE ka raportuar periodikisht pranë Kuvendit të Shqipërisë edhe mbi gjetjet e evidentuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë monitoruese ndaj të licencuarve dhe tregut të energjisë në tërësi.

Me qëllim hartimin e këtij raporti, në ERE ka filluar puna në muajt e parë të vitit 2026 dhe, me urdhër të Kryetarit të ERE-s, është ngritur grupi i punës me qëllim mbledhjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për hartimin e një raporti të plotë dhe analitik mbi gjendjen e sektorit të energjisë dhe veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2025. Ky grup pune ka përfshirë drejtoritë dhe sektorët përkatës të institucionit, të cilët kanë kontribuar në pasqyrimin e veprimtarisë së ushtruar gjatë këtij viti.

Në përpilimin e këtij raporti, ka pasur në konsideratë respektimin e parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili, në nenin 25, pika 2, parashikon, ndër të tjera, se në raportin vjetor duhet të trajtohen çështje si vijon:

a) siguria operative e rrjetit;

- b) balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare;
- c) niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektiva e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetëvjeçare nga data e raportit;
- ç) kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi;
- d) parashikimi i investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkonjeksionit;
- dh) cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjeteve;
- e) masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike;
- ë) masat e përshtatshme, në rast nevojë, për rritjen e sigurisë së furnizimit.

Me qëllim hartimin e një raporti të plotë, të argumentuar dhe informues mbi ecurinë e sektorit dhe veprimtarinë e ushtruar nga ERE, në zbatim të legjislacionit në fuqi, është mbajtur parasysh gjithashtu edhe detyrimi për të reflektuar zhvillimet më të rëndësishme të vitit 2025 në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe masat e marra nga ERE në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

Një vend të rëndësishëm në këtë raport zë pasqyrimi i treguesve kryesorë të sektorit të energjisë elektrike për vitin 2025. Në këtë kuadër, raporti paraqet të dhëna mbi kapacitetin total të instaluar prodhues në vend, prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, kontributin e prodhuesve publikë dhe privatë në mbulimin e kërkesës, ecurinë e prodhimit nga burimet e rinovueshme, veçanërisht nga impiantet fotovoltaike, si dhe ndikimin e kushteve hidrologjike në prodhimin vendas. Raporti analizon gjithashtu rezervën energjitike në kaskadën e lumit Drin, ecurinë e prodhimit në rrjetin e transmetimit dhe atë të shpërndarjes, si dhe rolin gjithnjë në rritje të burimeve të rinovueshme në strukturën e prodhimit vendas.

Një tjetër pjesë e rëndësishme e raportit lidhet me zhvillimet në sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në këtë drejtim, raporti trajton të dhëna mbi zgjerimin e sistemit të transmetimit gjatë vitit 2025, vënien në operim të linjave të reja dhe nënstacioneve, masat e marra nga OST sh.a. në vijim të rekomandimeve të ENTSO-E pas ngjarjes së datës 21 qershor 2024, si dhe ecurinë e humbjeve në sistemin e transmetimit. Po ashtu, raporti përfshin të dhëna mbi asetet kryesore të rrjetit të shpërndarjes, energjinë e hyrë në rrjet, nivelin e humbjeve, si dhe përmirësimin gradual të treguesve të performancës në sistemin e shpërndarjes.

Raporti pasqyron edhe ecurinë e konsumit të energjisë elektrike në vend, strukturën e konsumatorëve, zhvillimet në tregun e rregulluar dhe atë të parregulluar, si dhe ndryshimet që lidhen me daljen në treg të lirë të kategorive të caktuara të konsumatorëve. Në këtë pjesë përfshihen gjithashtu të dhëna për klientët e furnizuar nga FSHU sh.a., strukturën e faturimit, nivelin e arkëtimeve, si dhe zhvillimin e infrastrukturës së karikimit për automjetet elektrike, si një segment në rritje i tregut me ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën e konsumit të energjisë elektrike në vend.

Një peshë të veçantë në raport zë veprimtaria e ERE-s në fushën e shqyrtimit dhe miratimit të tarifave dhe çmimeve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Në këtë kuadër, raporti përfshin zhvillimet lidhur me tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, tarifat e shpërndarjes, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e furnizuar nga FSHU sh.a., çmimet e aplikuara për furnizimin nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, çmimet për shoqëritë ujësjellës-kanalizime, çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e automjeteve elektrike, si dhe tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.

Raporti trajton gjithashtu operimin dhe zhvillimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike nëpërmjet ALPEX sh.a., duke evidentuar ecurinë e anëtarësimit në bursë, zhvillimet në tregun e ditës në avancë dhe tregun brenda së njëjtës ditë, rritjen e aktivitetit tregtar dhe volumeve të tregtimit, si në zonën e ofertimit të Shqipërisë, ashtu edhe në kuadër të bashkimit të tregut Shqipëri–Kosovë.

Për sa i përket kuadrit rregullator, raporti evidenton veprimtarinë e ERE-s në miratimin e akteve nënligjore me rëndësi të veçantë për përafrimin e kuadrit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian dhe të Komunitetit të Energjisë. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025, ERE ka vijuar forcimin e kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, ndërsa Bordi i ERE-s ka zhvilluar 53 mbledhje, në të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar 348 vendime.

Në kuadër të forcimit të kuadrit rregullator të sektorit të energjisë elektrike dhe harmonizimit të tij me rregullat e Bashkimit Evropian dhe të Komunitetit të Energjisë, gjatë vitit 2025 ERE shqyrtoi dhe miratoi një paketë të rëndësishme aktesh rregullatore të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Këto akte rregullojnë aspektet kryesore të funksionimit dhe operimit të sistemit elektroenergjetik dhe të tregut të energjisë elektrike, duke përfshirë: rregullat për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe menaxhimin e kongjestionit, alokimin e kapaciteteve afatgjata ndërkufitare, balancimin e energjisë elektrike, operimin e sistemit të transmetimit, si dhe procedurat për menaxhimin e emergjencave dhe rivendosjen e sistemit elektroenergjetik.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 Bordi i ERE-s miratoi: Rregulloren për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Kongjestionit; Rregulloren “Për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata”; Udhëzuesin për Balancimin e Energjisë Elektrike; Udhëzuesin mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike; si dhe Kodin e Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen. Miratimi i këtyre akteve përbën një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit rregullator shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian dhe rritjes së sigurisë dhe eficiencës së operimit të sistemit elektroenergjetik.

Në sektorin e gazit natyror, raporti pasqyron veprimtarinë e ERE-s në lidhje me miratimin e ndryshimeve në Kodin e Rrjetit TAP, miratimin e Udhëzimeve për Testimin e Tregut 2025 të TAP

AG, si dhe miratimin e propozimit të projektit nga TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes së kapacitetit. Gjithashtu, raporti përfshin një pasqyrë mbi zhvillimet ndërkombëtare në sektorin e gazit natyror dhe veprimtarinë e shoqërive TAP AG dhe Albgaz sh.a. gjatë vitit 2025.

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të ERE-s për vitin 2025 është edhe licencimi në veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Në këtë kuadër, raporti pasqyron numrin e licencimeve të realizuara gjatë vitit në veprimtaritë e prodhimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, si dhe rastet e njohjes së licencave të lëshuara nga autoritete rregullatore të vendeve të tjera, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe marrëveshjet përkatëse.

Një vend të posaçëm në raport zë edhe mbrojtja e konsumatorit, si një nga shtyllat themelore të veprimtarisë së ERE-s. Në këtë pjesë pasqyrohet trajtimi i ankesave dhe kërkesave për informacion ose orientim të paraqitura nga konsumatorët gjatë vitit 2025, mënyrat e adresimit të tyre, si dhe angazhimi institucional i ERE-s për garantimin e trajtimit të drejtë, të përgjegjshëm dhe të barabartë të përdoruesve të shërbimit të energjisë elektrike.

Në zbatim të detyrimit ligjor të ERE-s për raportimin e veprimtarisë së saj brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, është përgatitur raporti bashkëlidhur këtij relacioni, pas grumbullimit të të dhënave të nevojshme nga të licencuarit dhe përpunimit të tyre, me qëllim përcjelljen në Kuvendin e Shqipërisë të një raporti të detajuar dhe analitik, i cili jep një pasqyrë të qartë mbi gjendjen e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe mbi veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit kalendarik 2025.

Për sa më sipër, dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 25 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 21 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, i propozohet Bordit të ERE-s:

- 1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2025”.**
- 2. Sekretari i Pergjithshem te marri masat per percjelljen e ketij Raporti Kuvendit te Shqiperise brenda dates 30.03.2026.**

Bashkëlidhur këtij relacioni gjeni Projekt-Vendimin përkatës, si dhe një kopje të raportit të përgatitur.

Me respekte,

Elton B. Radheshi

Sekretar i Pergjithshem



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË
BORDI

Projekt-VENDIM

Nr. __, Datë __.03.2026

MBI

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ERE-S,
“GJENDJA E SEKTORIT TË ENERGISJË DHE VEPRIMTARIA E ERE-S GJATË
VITIT 2025”

Në zbatim të neneve 16 dhe 25 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe nenit 21 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës __.03.2026, pasi shqyrtoi Raportin Vjetor për “Gjendjen e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2025” dhe relacionin e nr. ____ prot., datë __.03.2026, të përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë e kryetarit të Grupit të Punës së ngritur për përgatitjen e raportit vjetor të ERE-s “Për gjendjen e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2025”,

Konstatoi se:

- ERE, në zbatim të parashikimeve të nenit 25 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 21 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, paraqet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë raportin vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë elektrike, gazit natyror dhe veprimtarinë e ERE-s për vitin paraardhës, brenda datës 31 mars.
- Për hartimin e raportit vjetor për vitin 2025, me urdhër të Kryetarit të ERE-s është ngritur grupi i punës, i cili mori masat për mbledhjen, administrimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat e ERE-s dhe nga të licencuarit, me qëllim përgatitjen e raportit brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
- Raporti Vjetor i ERE-s pasqyron gjendjen e përgjithshme të sistemit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të nenit 25 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe zhvillimet në sektorin e gazit natyror. Po ashtu, ky raport pasqyron veprimtarinë e ERE-s në drejtim të monitorimit të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, veprimtarisë së të licencuarve, mbikëqyrjes së të drejtave të klientëve të energjisë, si dhe progresin e ERE-s në hartimin, miratimin dhe rishikimin e akteve rregullatore në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe rregullatore.
- Raporti përfshin të dhëna të detajuara mbi treguesit kryesorë të sektorit të energjisë elektrike për vitin 2025, përfshirë kapacitetin total të instaluar prodhues, prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, kontributin e prodhuesve publikë dhe privatë në mbulimin e kërkesës,

ecurinë e prodhimit nga burimet e rinovueshme, veçanërisht nga impiantet fotovoltaike, si dhe ndikimin e kushteve hidrologjike në prodhimin vendas.

- Raporti pasqyron zhvillimet në sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, duke trajtuar zgjerimin e sistemit të transmetimit, vënien në operim të linjave të reja dhe nënstacioneve, masat e marra nga OST sh.a. në vijim të rekomandimeve të ENTSO-E, si dhe të dhëna mbi asetet kryesore të rrjetit të shpërndarjes, energjinë e hyrë në rrjet, nivelin e humbjeve dhe përmirësimin e treguesve të performancës.
- Raporti përfshin gjithashtu zhvillimet në fushën e tarifave dhe çmimeve, duke trajtuar tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, tarifat e shpërndarjes, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e furnizuar nga FSHU sh.a., çmimet e aplikuara nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, çmimet për shoqëritë ujësjellës-kanalizime, çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e automjeteve elektrike, si dhe tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.
- Raporti trajton operimin dhe zhvillimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike nëpërmjet ALPEX sh.a., duke evidentuar ecurinë e anëtarësimit në bursë, zhvillimet në tregun e ditës në avancë dhe tregun brenda së njëjtës ditë, si dhe rritjen e aktivitetit tregtar dhe volumeve të tregtimit si në zonën e ofertimit të Shqipërisë, ashtu edhe në kuadër të bashkimit të tregut Shqipëri–Kosovë.
- Gjatë vitit 2025, ERE ka vijuar forcimin e kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, ndërsa bordi i ERE-s ka zhvilluar 53 mbledhje, në të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar 348 vendime.
- Në kuadër të forcimit të kuadrit rregullator të sektorit të energjisë elektrike dhe harmonizimit të tij me rregullat e Bashkimit Evropian dhe të Komunitetit të Energjisë, gjatë vitit 2025 ERE shqyrtoi dhe miratoi një paketë të rëndësishme aktesh rregullatore të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., të cilat rregullojnë aspektet kryesore të funksionimit dhe operimit të sistemit elektroenergetik dhe të tregut të energjisë elektrike.
- Raporti pasqyron edhe veprimtarinë e ERE-s në sektorin e gazit natyror, përfshirë miratimin e ndryshimeve në Kodin e Rrjetit TAP, miratimin e Udhëzimeve për Testimin e Tregut 2025 të TAP AG, si dhe miratimin e propozimit të projektit nga TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes së kapacitetit.
- Një pjesë e rëndësishme e raportit lidhet me aktivitetin e ERE-s në licencimin e pjesëmarrësve në treg, njohjen e licencave të huaja, si dhe me mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë trajtimin e ankesave dhe kërkesave për informacion ose orientim të paraqitura gjatë vitit 2025.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2025”, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë. (Raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.